




REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/20

Datë: 31.03.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të ligjit për vetëqeverisje lokale (Ligji nr.03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i kuvendit të Komunës së Junikut me numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1 të Rregullores mbi transparencën, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.03.2026 nxjerrë:

V E N D I M

për hapjen e diskutimit publik për plotesim ndryshim të projekt Rregullores për menaxhimin e mbeturinave

- I.** Me këtë vendim hapet diskutimi publik për plotesim ndryshim të projekt rregullores për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2026.
- II.** Plotesim ndryshimet e projekt rregullores nga pika I. e këtij Vendimi vihet në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.
- III.** Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
- IV.** Ekspozimi i plotesim ndryshimeve të projekt rregullores do të bëhet në zyrën e Drejtorisë për Shërbime Publike, në objektin e Komunës së Junikut.
- V.** Diskutimi publik i plotesim ndryshimeve të projekt rregullores zgjatë 15 ditë.
- VI.** Gjatë kohës së diskutimit publik plotesim ndryshimet e projekt Rregullores ekspozohen edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut, për shqyrtim dhe komente.
- VII.** Diskutimi publik i plotesim ndryshimeve në projekt Rregullore, organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Junikut.
- VIII.** Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të kësaj projekt Rregulloreje.
- IX.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Shërbime publike e Komunës së Junikut.

X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministries përgjegjëse për vetëqeverisje locale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL,
2. Kryetari i Komunës së Junikut,
3. Drejtorja për Shërbime Publike,
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës,
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard F. Jollani

